

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 586 Prot.

Tiranë, më 23.06 2016

VENDIM Nr. 46, datë 20.05.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.6 të datës 20.05.2016, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Koman"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, bashkëdrejtuese Dr. Etleva Nallbani (CNRS 8167/Orient et Méditerranée, Collège de France, Paris), Dr. Elvana Metalla (IA),

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Koman"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, bashkëdrejtuese Dr. Etleva Nallbani (CNRS 8167/Orient et Méditerranée, Collège de France, Paris), Dr. Elvana Metalla (IA), në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Gërmime në zonën e poshtme të kodrës së "kalasë" (Zona 1B).
 - Pastrime dhe gërmimi i murit masiv në jug të kishës.
 - Konsolidime në zonën e kishës së Shën Gjergjit.
 - Pastrime në zonën më të sipërme 1C dhe në zonën e nekropolit. Këtu do fillojë konsolidimi i varreve të zbuluara nga gërmimet e vjetra".
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë 4 korrik – 7 gusht 2016.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO